



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 2, nenit 15 paragrafët 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.04/L-060 për Menaxhimin e Mbeturinave , nenit 2 të Rregullores 15Nr. 352-47361 për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit e datës 30.09.2020 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2027

Neni 1

MIRATOHET , Plani për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit 2023-2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit 2023-2025

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 dhe 17 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 2, nenit 15 paragrafët 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.04/L-060 për Menaxhimin e Mbeturinave, nenit 2 të Rregullores 15Nr. 352-47361 për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit e datës 30.09.2020 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Projekt-Plani për menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit është hartuar nga grupi punues për hartimin e Projektit të Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e GIZ (shoqata gjermane për bashkëpunim).

Projekt-Plani për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Lipjanit 2023-2027 ka qenë në konsultim publik dhe përkitazi me këtë është mbajtur edhe debati publik konform dispozitave përkatëse ligjore.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

INr. 352/01-55228
Lipjan, Më 26.09.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



Projekt



PLANI KOMUNAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

2023-2027

Komuna e Lipjanit

1.	Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit	5
1.1.	<i>Qëllimi dhe fushëveprimi i planit</i>	5
1.2	Baza ligjore për hartimin e planit	6
2.	<i>Konteksti lokal</i>	8
2.2	Resurset natyrore	10
2.3	Popullsia	12
2.4	Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit	13
3.3	Rishikimi i implementimit të planit	26
3.4	Performance e shërbimit	28
3.5	Performanca financiare e MM	29
3.6	Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave	31
3.3	Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave	31
4	<i>Objektivat e MM dhe plani operacional</i>	33
4.1	Vizioni i MM	33
4.2	Objektivat dhe caqet e MM	33
4.3	Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave	33
4.4	Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave	36
4.5	Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM	43
4.6	Objektivi nr. 4: Deponimi i sigurt i mbeturinave si mjet i fundit	46
4.7	Objektivi 5: Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave	47
4.8	Plani i MM në kushte emergjente	48
5	<i>Plani financiar, veprimit dhe i monitorimit</i>	49

Lista e shkurtesave:

AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BMZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
CEDE	Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit
DRS	Sistemi i kthimit të depozitës
ELV	Automobila mbeturinë
EPR	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
GIZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
QeK	Qeveria e Kosovës
ITMB	Impijanti për trajtimin mekanik biologjik
IWMS	Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KIWER	Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit
KLMC	Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
MESPI	Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës
MND	Mbeturina nga ndërtim demolimi
MPEE	Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike
MRF	Qendra e rikuperimit të materialit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PKMM	Plani komunal për menaxhim të mbeturinave
PPP	Partneriteti publik privat
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
SIMM	Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave
WFD	Direktiva kornizë e mbeturinave

Lista e tabelave

Tabela 1	Të dhënat mbi popullatën
Tabela 2	Bilanci i mbeturinave komunale
Tabela 3	Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale
Tabela 4	Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës
Tabela 5	Mbulimi me shërbim në territorin e komunës
Tabela 6	Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit
Tabela 7	Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit
Tabela 8	Pajisjet për hudhjen, ruajtjen dhe grumbullimin e mbeturinave
Tabela 9	Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave
Tabela 10	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 11	Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM
Tabela 12	Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave
Tabela 13	Shpenzimet e sistemit të MM
Tabela 14	Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM
Tabela 15	Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit
Tabela 16	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 17	Lista e objektivave të planit
Tabela 18	Korniza strategjike e Objektivit 1
Tabela 19	Korniza strategjike e Objektivit 2
Tabela 20	Parashikimet demografike të popullatës
Tabela 21	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave
Tabela 22	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit
Tabela 23	Analiza e potencialit të mbeturinave që mundën të ricikohen
Tabela 24	Korniza strategjike e objektivit 3
Tabela 25	Operacionalizimi i zgjerimit më shërbim
Tabela 26	Mbulimi me shërbim
Tabela 27	Treguesi i prezencës së deponive ilegale
Tabela 28	Efikasiteti i stafit
Tabela 29	Korniza strategjike e objektivit 4
Tabela 30	Korniza strategjike e objektivit 5
Tabela 31	Investimet kapitale sipas objektivave
Tabela 32	Investimet kapitale vjetore
Tabela 33	Numri i stafit direkt të grumbullimit dhe transportit
Tabela 34	Korniza e veprimit dhe monitorimit

1. Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit

1.1. Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM), është dokument i planifikimit nëpërmjet të cilit komuna e Lipjanit mundëson përmbushjen e obligimeve ligjore në fushën e menaxhimit të mbeturinave, si dhe harmonizimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në këtë fushë.

Përmes PKMM-së, komuna mundëson një qasje të menaxhimit të integruar të mbeturinave, duke zbatuar një sërë masash, ku synimi kryesor është reduktimi i mbeturinave komunale që gjenerohen në burim, ngritja dhe zhvillimi i infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave, aspektet financiare të sistemit, aspekte tjera siq janë monitorimi i gjendjes në këtë sektor, bashkëpunimi me të gjithë akterët, ndërgjegjësimi i popullatës etj.

PKMM përfshin:

- Përcaktimin e prioritetëve të sektorit me qëllim përmbushjen dhe përafrimin me objektivat e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (SMIM) 2021-2030 dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Mbeturinave (PVMIM) 2021-2023;
- Vendosjen e aktiviteteve dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete për realizimin e tyre me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuar;
- Përzgjedhjen e opsioneve më të mira me qëllim të realizimit të ciklit të menaxhimit të mbeturinave komunale;
- Rregullimin e apsketeve organizative dhe operacionale në bashkëpunim me akterët tjerë të përfshirë në menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Rolin dhe përgjegjësitë institucionale, dhe rregullativen funksionale të sistemit të menaxhimit të mbeturinave (MM);
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të kuadrit, me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes në këtë sektor; rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes etj.;
- Rregullimet financiare, duke pasqyruar nevojat financiare me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit të mbeturinave, si dhe analizimin e burimeve financiare për investime në sektor.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe vepruese për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e projekteve, buxheteve dhe planeve investuese, si dhe tërheqjen e mbështetjes financiare dhe profesionale.

1.2 Baza ligjore për hartimin e planit

Baza ligjore për hartimin e PKMM-së, është përcaktuar në Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i cili rregullon aspektet e menaxhimit të mbeturinave. LM ofron rregullimet bazë mbi MM, duke përfshirë klasifikimin e mbeturinave, rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq në menaxhimin e mbeturinave, si dhe aspektet tjera që kanë të bëjnë me kushtet dhe standardet e operimit, licencimit të operatorëve për MM etj.

Në Nenin 8, paragrafin 1., të LM, janë përcaktuar dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave për të gjitha nivelet e përgjegjësisë, kurse në nën paragrafin 1.3. të LM si dokument planifikues për komuna është përcaktuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave. Në nenin 10, paragrafin 2 të këtij ligji, shprehimisht komuna është obliguar që të nxjerrë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave.

1.2.1 Korniza ligjore për Menaxhimin e Mbeturinave

Në mënyrë specifike në Nenin 15 të Ligjit për Mbeturina, janë përcaktuar detyrimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës me qëllim të menaxhimit të mbeturinave.

Më konkretisht komuna duhet ta hartoj PKMM-në në harmoni me planin kombëtar, të ndërtoj sistemin e qëndrueshëm për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave të të gjitha fraksioneve, caktimin e modelit finaciar të operimit për shërë e ofruara, monitorimin e gjendjes në territorin e komunës, hartimin e raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave etj.

Rregullativa ligjore përfshin edhe një sërë ligjesh tjera sektoriale, të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë MM dhe ato ligje janë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Kështu, Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton MM si kompetencë të komunave duke përfshi përfshi edhe aspektet eoperative të ofrimit të shërbimit dhe rregullimet financiare të shërbimit.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike pos tjerash rregullon edhe aspektet që kanë të bëjnë me themelimin e ndërmarrjeve komunale, rregullimet e pronësisë së tyre, pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen kooperative, rregullimet dhe transparencën financiare etj.

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore të nivelit qendrorë që rregullojnë MM janë edhe:

- **Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë**- dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Dokumenti synon të trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027

Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtonë aspektet e MM janë:

- Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës
- Plani zhvillimor i Komunës së Lipjanit 2013-+2023+;

1.2.2 Korniza institucionale për Menaxhimin e Mbeturinave

Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve sa i përket MM janë të përcaktuara me LM dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore. Autoritetet kryesore për MM janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, komunat si dhe institucionet tjera relevante.

Sipas LM, Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme në bashkëpunim me komunat, ndërsa në anën tjetër komunat i menaxhojnë mbeturinat inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre.

Neni 14 i LM përcakton kompetencat e Ministrisë, të cilat përfshijnë: (i) Hartimin e ligjeve, strategjive dhe politikave për MM, dhe kujdeset për zbatimin e tyre; (ii) licencimin e operatorëve që meren me MM; (iii) krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemin informative për MM; (iv) koordinon punën me ministri dhe institucione tjera relevante lidhur me MM etj.

Neni 15 i LM përcakton kompetencat e komunave të cilat përfshijnë: (i) krijimin e sistemit të qëndrueshëm të MM dhe hartimin e PKMM; (ii) përzgjedhjen e operatorëve të licencuar për MM; (iii) caktimin e tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare për shërbë e ofruara; (iv) mbikqyrë dhe kontrollon zbatimin e masave dhe veprimeve për të parandaluar keqmenaxhimin e mbeturinave; (v) komuna nxjerr akte nënligjore me të cilat e rregullon funksionimin e organeve kompetente komunale dhe standardet e shërbimit për MM; (vi) ofron shërbime dhe infrastrukturë publike adekuatë për MM; (vii) harton raportin vjetor për MM etj.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave në marrëveshje me komunat;
- **Ministria e Shëndetësisë** - Menaxhimin e Mbeturinave Medicinale;
- **Ministria e Punëve të Brendshme** - Bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat;
- **Ministria e Bujqësisë** - është përgjegjëse për rregullimin e aspekteve të MM nga produktet medicinale në veterinarë dhe mbeturinat tjera shtazore;
- **Dogana e Republikës së Kosovës** - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave;

- **Policia e Republikës së Kosovës** - bashkëpunon me institucionet vendore, agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara të ndërlidhura me mbeturinat.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si në vijim:

- **Drejtoria për Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim (DSHPMSH)** – mbikqyrë dhe monitoron funksionimin e ofrimit të shërbimeve të përgjithshme komunale si: furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, ndriçimin publik, mirëmbajtjen dhe pastërtinë e hapsirave publike etj. DSHPMSH është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave komunale dhe atyre nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve;
- **Drejtoria për Inspeksion** - kryen mbikqyerjen inspektive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë edhe gjendjen sa i përket menaxhimit të mbeturinave;
- **Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DPUMM)** është përgjegjëse për caktimin e një lokacioni për deponimin e mbeturinave inerte. Poashtu është përgjegjëse edhe për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e mbrojtjes së mjedisit;
- **Drejtoria për Infrastruktur** - është përgjegjëse për mbikqyerjen dhe menaxhimin e të gjitha kontratave të infrastrukturës së komunës, si dhe kontratave të ofrimit të shërbimeve publike.
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF)** - është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- **Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A, Prishtinë**, njësi operative në komunën e Lipjanit, ofron shërbimin e mbledhjes së Mbeturinave në teritorin e komunës, si dhe bënë transportimin e Mbeturinave në deponinë sanitare rajonale në Mirash.

2. Konteksti lokal

2.1 Pozita gjeografike

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike sepse gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Ferizaj, Gjilan dhe Artanë.

Territori i komunës së Lipjanit ka sipërfaqe të tërësishme prej 33,814.9 ha dhe shtrihet në mes të gjerësisë gjeografike veriore 42°31'- 42°52' dhe të gjerësis lindore gjeografike 18°30' - 18°45'. Përmes territorit të komunës rrjedh lumi Sitnica, përreth dhe përgjatë të cilit shtrihen sipërfaqet më të plleshme bujqësore, të përshtatshme për prodhimtari bujqësore intensive.

Territori i Komunës së Lipjanit gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600 m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë.

Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunës.

Komuna paraqitet në ndarje të tërthortë në rrafsh të Fushës së Kosovës e rrafshlartat e Blinajës, Caralevës dhe Drenicës në perëndim dhe rrafshlarta e rrafshit të Androvackës në lindje. Lugina e Drenicës kalon nëpërmes të pjesës perëndimore të komunës (zona përreth Shalës). Kjo zonë ka lidhje më të afërt hapsinore me Glllogovcin. Qyteti i Lipjanit shtrihet në mes të rrafshit të Fushës së Kosovës në një lartësi përafërsisht rreth 550 m. majet më të larta në lindje dhe perëndim së bashku arrijnë mbi 1000m.

Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës dhe mbulon sipërfaqen prej 338.47 km². Ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor – hekurudhor, por edhe atë ajror, për shkak se Aeroporti i vetëm ndërkombëtarë i Republikës së Kosovës, ndodhet në lokalitetin Vrellë të Komunës së Lipjanit, vetëm 15 km nga qendra e qytetit. Përmes territorit të Komunës së Lipjanit kalon hekurudha e cila lidhë këtë territor në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi.

Qyteti i Lipjanit është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme 25/E 752 dhe 2/E 65, dhe të hekurudhës kryesore Mitrovicë-Shkup, dhe qyteti është i pajisur mirë me infrastrukturë rrugore dhe pozitë të favorshme në raport me rrethinën.


Në anën perëndimore shtrihet rezervati Blinaja që do të mund të zhvillohej në një qendër rekreative dhe atraktive për tërë rajonin, kurse në lokalitetin e Gadimes gjendet Shpella e Mermerit që paraqet një atraksion të rëndësishëm turistik jo vetëm për Komunën e Lipjanit por edhe për tërë vendin. Në anën tjetër parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër Janjeva paraqesin një potencial shtesë për komunën e Lipjanit me mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit.

Komuna e Lipjanit ka 62 fshatra, numri më i madhë i të cilave është i koncentruar në fushëgropën e Kosovës që paraqet pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit, ndërsa vendbanimet e tjera shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjik-pjesëve kodrinore malore të Komunës së Lipjanit.

Poashtu komuna e Lipjanit ndodhet në afërsi të qendrave më të mëdha të Republikës së Kosovës si:

Lipjan – Prishtinë	16 km
Lipjan – Mitrovicë	57 km
Lipjan – Prizren	60 km
Lipjan – Gjakovë	96 km
Lipjan – Pejë (përmes Prizrenit)	131 km
Lipjan – Ferizaj	26 km

Plani komunal p



Lipjan – Gjilan50 km.

Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Lipjanit në Kosovë

Klima- komuna e Lipjanit ka një klimë të mesme kontinentale me dimra relativisht të butë dhe verëra mesatarisht të nxehta. Sipas të dhënave të IHMK (Instituti Hidrometeorologjik të Kosovës), muajt më të nxehtë të vitit janë Korriku dhe Gushti me një temperaturë mesatare 20.5-20.6 gradë celcius, ndërsa muaji më i ftohtë është Janari me temperaturë mesatare -1.4 gradë celcius. Temperatura mesatare vjetore vlerësohet të jetë 10 gradë celcius, ndërsa në zonat malore temperatura zbret deri në -9 gradë celcius. Maksimumi absolut i temperaturës është arritur në muajin Gusht rreth 37.3 gradë celcius, ndërsa më e ulta gjatë muajit Janar rreth -26 gradë celcius.

Lagështia mesatare vjetore e ajrit vlerësohet të jetë rreth 74.7%. Muaji Gusht është muaji më i thatë me një lagështi rreth 63%, ndërsa Janari është muaji me lagështinë më të madhe 86.1%.

Në këtë regjion vrentësimi mesatar vjetor është 57%, ku gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellta është 57.9, të cilat përbëjnë rreth 15.9% të ditëve të vitit.

Sasirat e të reshurave në këtë rajon janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë, ku kemi një sasi mesatare vjetore rreth 673.3mm. Shpesh herë të reshurat në formën e Breshërit kanë shkaktuar dëme në ekonominë lokale të vendit, ndërsa reshjet e dëborës nuk paraqesin ndonjë problem në komunë, pasi ato janë në sasi të mëdha vetëm në zonat malore.

Frekuencën më të madhe vjetore në këtë rajon e kanë erërat verilindore me 226 0/00 ndërsa më pak e kanë erërat lindore (E) me gjithësej 36 0/00. Shpejtësi mesatare më të madhe e kanë erërat jugperëndimore me 4m/sec.

2.2 Resurset natyrore

Komuna e Lipjanit është e pasur me resurse natyrore të cilat janë potencial për zhvillim.

Më të rëndësishme janë mineralet, të cilat më së shumti gjenden në pjesët perëndimore dhe lindore të Komunës ndërsa në pjesën qendrore është e pasur me thëngjill. Mineralet më të rëndësishme të pranishme në komunën e Lipjanit janë: Magneziti, Nikeli, Thëngjilli, Zinku, Kromi, Duniti, Rëra, Kuarci dhe Zhavori.

Komuna e Lipjanit është e pasur me lëndë të para minerale, madje në sasi dhe cilësi të lartë. Më të rëndësishme janë lëndet e para minerale energjetike në radhë të parë thëngjilli. Vendburimet e qymyrit ndodhen në lokalitetin Babush, që janë vazhdimsi e basenit të rrafshit të Kosovës. Eksplotimi i qymyrit në Minieren e Babushit ishte bërë gjatë viteve të 80 – ta.

Lëndët e para minerale të metaleve në komunën e Lipjanit identifikohen me xeheroret e Hekurit dhe Nikelit të cilat gjenden në lokalitetet Magure dhe Medvec. Eksploatimi i këtyre xeheroreve viteve të fundit është bërë nga kompania-shkëritorja Feronikel. Mandej kemi lëndët e para të xeheroreve të Kromit të përhapura në masivin e Goleshit.

Lëndët e para mieralet të jometaleve të cilat në komunën e Lipjanit gjenden në sasi të mëdha dhe me cilësi të lartë përfshijnë: rezervat e magnezitit, dunitëve gëlqerorëve, rërave kuarcore, mermereve, zhavoreve etj.

Këto lëndë të para jometalore prodhohen në sektorin e ndërtimit, për prodhimin e produkteve të ndryshme si blloqeve, xhamave industrial dhe sanitarisë, materialeve zjarrruduese etj.

Tokat - Në territorin e komunës së Lipjanit gjenden 22 tipe tokash me një numër të madh nëntipesh. Tipet më të përfaqësuara janë: smonicat më tepër se 25.24% të cilat sipas cilësive të veta dhe karakteristikave prodhuese janë toka mjaftë të plleshme me përbërje kryesisht të argjilit, neutrale deri të reaksioni i dobët acidik, të pasura me humus dhe kalium aktiv.

Tokat aluviale përfaqësohen me rreth 22.87%, kryesisht këto toka gjenden rreth degëve të lumit "Sitnica". Këto janë toka me veti të përshtatshme fiziko-ujore dhe me vlerë të lartë bujqësore. Në këto toka organizohet prodhimtari intensive bujqësore. Tokat e kafenizuara të cekëta në rrasat shkëmbore-ranore janë të përfshira me rreth 5.67% dhe Tokat e kafenizuara të mesme të thella në rrasat shkëmbore-ranore përfshinë 8.54% dhe. Këto toka dhe tokat tjera të kafenizuara gjenden në terrenet e larta dhe kryesisht janë toka pyjore nën pyje.

Tokat livadhore –teltnore dhe tokat livadhore-argjillore janë të përfaqësuara me rreth 3% dhe gjenden kryesisht përreth lumit "Sitnica". Tokat podzole-pseudoglej janë toka të cilat e kanë vlerën e kufizuar bujqësore për shkak të cilësive (vetive) të këqija ujoro-fizike dhe shtresën punuese e cila nuk e lëshon ujin, kjo shtresë është me përmbajtje të madhe argjillore. Në mënyrë që këto toka të shfrytëzohen intensivisht në bujqësi është e nevojshme që të bëhen masat agromelioruese. Tokat deluviale përfshinë 5.36% nga territori i përgjithshëm i komunës.

Pyjet – në komunën e Lipjanit pyjet shtrihen në perëndim (rrafshlartat e Blinajës, Caralevës dhe Drenicës-Shalës) dhe në jug-lindje rrafshlarta e rrafshit të Androvackës (Janjeva, Sllovi dhe Gadime). Një pasuri e veçantë pyjore ndodhet në vendgjuetinë e mbrojtur të rëndësisë së veçantë "Blinaja" ku kemi një zonë të madhe pyjore të mbrojtur e cila shtrihet në jugperëndim të komunës së Lipjanit. Në masivin malor të lokalitetit Gadime (kodra e murturit), ndodhet Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes", e cila ka një gjatësi prej 1400m.

Prej sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve të në komunën e Lipjanit; • 1621.023 ha janë pyje të larta, • 2993.21 ha pyje të ulëta • 11038.16ha janë shkurre.

Ujërat - Në aspektin hidrografik ujrat në komunën e Lipjanit i takojnë pellgut të Detit të Zi, ndërsa lumenjtë më të mëdhenjë janë lumi Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Në përgjithësi rrjeti hidrografik është i pasur dhe me potencial ujorë të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumvjeqare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madhë në komunën e Lipjanit i cili degët më të zhvilluara i ka në anën lindore, ndërsa degët kryesore hidrografike të anës lindore janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi Sazlisë ndërsa, në anën perendimore lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit. Sasitë më të mëdha të reshurave janë gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet.

2.3 Popullsia

Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 komuna e Lipjanit kishte 57,605 banorë, ndërsa sipas vlerësimit të vitit 2021, komuna ka 58,601 banorë, duke shënuar një rritje prej 1.7%.

Tabela 1: Popullsia e komunës së Lipjanit sipas regjistrimit 2011 dhe vlerësimit 2021

Regjistrimi ASK 2011		Vlerësimi ASK 2021	
Numri i populates	Numri i amvisërive	Numri i populates	Ngritje / zbritje %
57,605	9,497	57,457	- 0.3 %

Sa i përket migrimit vërehet se ka migrim kryesisht ndërkombëtarë të popullsisë, ndërsa migrimi kombëtarë është në shkallë më të vogël (tabela 3).

Tabela 2: Migrimi për vitin 2021 në Komunën e Lipjanit

Gjithësej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020)	Migrimi ndërkombëtar 2021			Migrimi Kombëtar 2021			Bilanci i përgjithshëm i migrimit	Gjithësej popullësia dhe migrimi 2021
	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit ndërkombëtar	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i Migrimit Kombëtar		
57,928	127	1,186	-1,059	221	306	-85	-1,144	56,784

Në qytetin e Lipjanit jetojnë rreth 6,870 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në zonat rurale. Rreth 88% jetojnë në vise rurale, kurse vetëm rreth 12% në pjesën urbane. Dendësia e popullsisë është 170 b/km², e përafërt me mesataren e popullsisë në shkallë vendi 205 b/km². Në lidhje me përbërjen e etnive që jetojnë në komunë kemi këtë shpërndarje: shqiptarë (89%), serb (6%), kroatë (1%), romë (1%) dhe 2.9% të tjerë. Moshë e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40% janë të moshës 0 -14 vjeç, 45% janë të moshës 15 -65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç.

Në lidhje me madhësinë e familjeve janë bërë disa hulumtime demografike gjatë vitit 2002 dhe gjatë vitit 2003, ku është vlerësuar që madhësia mesatare në Republikën e Kosovës është 6.4 persona/familje, 6.8 persona/familje për zonat rurale dhe 5.5 persona/familje për

zonat urbane. Në rastin e Komunës Lipjan madhësia mesatare e personave në familje vlerësohet të jetë 5 persona/familje. Numri i meshkujve në komunën e Lipjanit është 29,23, kurse numri i femrave 28, 285.

2.4 Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit

Problemet me të cilat ballafaqohet mjedisi në komunën e Lipjanit, i atribuohen kryesisht mosmenaxhimit të duhur të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta, të cilat ndotin tokën dhe ujërat. Në anën tjetër aktivitetet në bujqësi, gurëthyesit, degradimi i pyjeve, ndërtimet në tokat bujqësore, veprimtaritë e **caktuara** biznesore, komunikacioni dhe aktivitete tjera janë një kontribues i madhë i ndotjes mjedisore.

Ndotja e tokës - Mbeturinat e ngurta të akumuluar në deponitë ilegale janë ndër ndotësit kryesorë të tokës në komunë. Këto janë kryesisht deponi ilegale të mbeturinave të përziera shtëpiake, dhe atyre nga ndërtimi, të përqendruara kryesisht përgjatë rrugëve. Ndikimet negative të këtyre deponive janë të shumta, ku përveç kontaminimit të drejtpërdrejtë të tokës dhe ajrit, ndikimi i tyre mund të bartet në rrjedhat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nëpërmjet reshjeve. Bazuar në të dhënat e fundit të regjistrimit të deponive ilegale në komunën e Lipjanit qershor 2021, janë identifikuar 88 deponi.

Përdorimi joracional i pesticideve në sektorin e bujqësisë është një burim tjetër i mbingarkesës së tokave bujqësore me këto preparate, të cilat kanë një efekt afatgjatë negativ në mjedis dhe në shëndet.

Ndotja e ajrit – Gjendja e cilësisë së ajrit në territorin e vendit monitorohet nga matjet sistematike të 12 stacioneve monitoruese të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK). Nga këto stacione monitorohen ndotësit: PM₁₀, PM_{2.5}, NO₂, SO₂, O₃ dhe CO. Normat e cilësisë së ajrit të zbatueshme për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë janë të përcaktuara sipas U. A Nr.02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit.

Të dhënat për cilësinë e ajrit në Kosovë janë të mangëta për shkak të mungesës së një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit nëpër të gjitha komunat. Gjithashtu, inventari i ndotësve nuk është zhvilluar ende për komunat specifikisht. Si rezultat i kësaj gjendje nuk mund të flasin me kompetencë për nivelin aktual të ndotjes dhe cilësinë e tij. Bazuar në njohuritë e përgjithshme sondazheve në terren, burimet kryesore të ndotjes në komunën e Lipjanit mund të konsiderohet se janë: ndezja e mbetjeve të plastikës dhe gomës, ndezja e hamulloreve, ndezja e mbetjeve në deponi të egra, gurëthyesit, trafiku rrugor, sidomos në afërsi të rrugëve rajonale e nacionale, e sidomos brenda qytetit të Lipjanit, ngrorja nga amvisërit etj.

Cilësia e ujërave - Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e zeza të patrajtuara, të cilat përmes kanalizimeve joadekuate derdhen kryesisht në rrjedhat lumore dhe në tokat bujqësore. Në këtë formë shkakthet ndotje e ujërave nëntoksore dhe sipërfaqësore, duke ndikuar edhe në jetëbimore dhe shtazore. Për të përmirësuar gjendjen sa i përket ujërave të zeza në vitin 2019 ka filluar ndërtimi i kolektorit në zonën afër lumit Sitnica, i cili është planifikuar që të liodhet me impiantin qëndror për trajtimin e ujërave të zeza në regionin e Prishtinës. Po ashtu komuna me mbështetjen e MMPHI-së

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027

është duke bërë rregullimin e shtretërve të lumenjve, me qëllim përmirësimin e gjendjes së lumenjëv.

Rrjeti i furnizimi me ujë të pijes në komunën e Lipjanit nga sistemi i ujësjellësit që menaxhohet nga KRU Prishtina ende nuk është shtriturë në të gjitha lokalitetet e komunës, dhe me qenësë popullata e komunës së Lipjanit mbi 90 % i takon zonës rurale furnizohet me ujë për pije edhe nga puset. Mirëpo, ka indikacione se ky ujë nga puset në masën më të madhe nuk i plotëson standardet e ujit të pijes që siq e cekëm më lartë është i ndikuar nga ndotja e tokës.

Përqindja e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm është 66.13%.

Zhurma - Sa i përket ndotjes nga akustike nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, kështu që mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme. Edhe pse nuk ka ndonjë studim specifik, mund të konkludojmë se komunikacioni është një ndotës akustik, për faktin se në territorin e komunës së Lipjanit kalojnë autostradat që lidh Kosovën me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut, pastaj rrugët dhe kryqëzimet kryesore, pastaj aeroporti ndërkombëtar "Adem Jashari" dhe hekurudha, padyshim se është e ndikuar nga zhurma. Kontribues tjetër i zhurmës gjithashtu mund të konsiderohet edhe sektori i veprimtarisë prodhuese dhe shërbyese në një masë të caktuar.

Biodiversiteti përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në bote. Vlerësohet se trendi i sotshëm i kërcënimit të ekosistemeve natyrore do të paraqes rrezik për të ardhmen e njerëzimit dhe mund të sjell pasoja të rënda në natyrë.

Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'iu lëmë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë. Shumëllojshmëria bimore dhe shtazore ka rëndësi të madhe shëndetësore, ekonomike, shkencore, edukative-arsimore, turistike-rekreative etj.

Në komunën e Lipjanit deri më tani janë vënë nën mbrojtje disa zona me rëndësi të veçantë.

Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" - ndodhet në fshatin Gadime e Ulët të Komunës së Lipjanit, e lokalizuar në kodre e "Mërturit", ndërsa hyrja ndodhet në pjesën e poshtme të grykës së lumit (përroskës) Klytura në lartësi mbidetare 580 metra. Për shkak të vlerave të mëdha, kristaleve, dukurive shpellore interesante dhe pozitës së përshtatshme shpella përgatitet dhe hapet për vizitor në vitin 1976.

Vend Gjuetia e Rëndësisë së Veçantë "BLINAJA"- Shtrihet në tri Komuna, atë të Lipjanit, Drenasit dhe Shtimes dhe ka një sipërfaqe prej 2795/ha, dhe është e tipit të mbyllur. Karakterizohet me zoodiversitet të pasur. Kjo njësi menaxhimi shtrihet në pjesën perëndimore të ultësirës së Kosovës, në jugperëndim të Prishtinës në largësi prej 32 km dhe ngrihet në lartësi 600 - 850 m mbi nivelin e detit, në një rajon kodrinor. Sipas destinimit, është zonë gjuetie me rëndësi të veçantë, e themeluar në vitin 1955 dhe rithemeluar në shkurt të vitit 2009.

Ligatina e Hencit-Radevës e lokalizuar ndërmjet komunave F. Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, me një sipërfaqe prej 109 ha. Është zonë me vlera dhe karakteristika të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrologjike, botanike dhe peisazhore.

Monumenti i Natyrës “Burimet e Ujit” në fshatin Baicë- monument i natyrës me karakter hidrologjik me një sipërfaqe prej 5 ari. Gjithashtu janë vënë nën mbrojtje një numër i madhë i Monumenteve të Natyrës me karakter botanik si: “Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*)” në fshatin Gadime e Epërme; Trungu i Bungbutës (*Quercus pubescens*)” në fshatin Dobrajë e Madhe, dhe kështu një mori vlera tjera botanike nëpër lokalitete të ndryshme të komunës së Lipjanit janë vënë nën mbrojtje sipa dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

Flora – Fitodiversitetit në komunën e Lipjanit shkon deri te brezi i ahishteve (*Fagus silvatica*) të përziera me bungë (*Quercus petraea*), ndërkaj në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqime mjaft të mëdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve, vendbanimeve, dhe në tokat djerrina.

Fauna- Komuna e Lipjanit karakterizohet me një zoodiversitet të pasur. Për rëndësinë e biodiversitetit shquhet Vend Gjuetia e Rëndësisë së Veçantë “Blinaja”, me një llojllojshmëri të madhe të faunës. Ky rezervat shtrihet në një sipërfaqe prej 2795ha. Llojet kryesore të faunës së egër në Blinajë janë: Derri i egër (*Sus scrofa*) - me rreth 500 krerë, Dreri i kuq (*Cervus elaphus*) - rreth 150 krerë, Dreri i murrmë (*Dama dama*) - rreth 100 krerë, Kaprolli (*Capreolus capreolus*) - rreth 170 krerë. Lloje tjera prezentë janë edhe Vjedulla (*Meles meles*), Shqarthe i ahut (*Martes sp.*), Shqarthe i pishës evropiane (*Martes sp.*), Lepuri (*Lepus europeus*), Korbi (*Corvus corax*), Laraska (*Pica pica*), Shqiponja minj ngrënëse (*Buteo buteo*), Rosa e egër (*Anas querquedula*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), Ketri (*Sciurus vulgaris*), etj.

2.5 Të dhënat mbi ekonominë lokale

Komuna e Lipjanit me shtrirjen gjeografike që ka, dhe me resurset natyrore ka një potencial të madh për zhvillim ekonomik.

Në komunën e Lipjanit veprimtarit kryesore sipas bizneseve që operojnë janë tregtia, transporti, prodhimi, ndërtimtaria, hoteleria dhe të tjera. Shumica e bizneseve janë të orientuara në tregti që në përqindje sillen rreth 50%, transporti me 17.6%; prodhimi 8.7%; ndërtimtaria 10% hoteleria me 7.0% të tjera me 10.4%.

Meqenëse komuna e Lipjanit posedon në pronësi të veten sipërfaqe relativisht të mëdha të tokës, kjo i mundson komunës investime të përbashkëta me partneritetin publiko-privat. Në këtë kuptim komuna ka shpallur tri zona ekonomike: Zona ekonomike në fshatin Konjuh, Zona ekonomike- parku industrial në zonën kadastrale në Qylagë (562,456m²) dhe Zona Ekonomike në Babush.

Në zhvillimin ekonomik të komunës së Lipjanit një ndikim të madh ka edhe turizmi, pasi siq dihet në komunën e Lipjanit ndodhen disa atraksione turistike siq janë: Shpella e Gadimes, lokaliteti i Janjevës si vendbanim i vjetër, ujërat termale në fshatin Baicë, pylli i mbrojtur

“Blinaja”, gryka e Shalës, Zona e Interesit të Veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë” etj.

Tabela 3: Bizneset sipas komunave, ARBK

Lipjan	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërmarrje publike	Ndërmarrje shoqërore	Ortakëri	Ortakëri e përgjithshme	Shoqri aksionare	Sh.p.k	Total
	3,750	22	2	-	1	1	104	3	636	4519

2.6 Bujqësia

Bujqësia është degë shumë e rëndësishme e zhvillimit të komunës, dhe luan një rol të rëndësishëm në mirëqenien e popullatës në komunën e Lipjanit.

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të Komunës Lipjanit është 33849.035ha. Struktura e sipërfaqeve është relativisht e përshtatshme meqenëse në tokat bujqësore bëjnë pjesë më tepër se 60% nga sipërfaqet e përgjithshme të territorit të komunës, gjersa në ato pyjore rreth 33.51% e në tokat e papllëshme 6.26%.

Sipas regjistrimit të bujqësisë ASK 2014, numri i ekonomive bujqësore në komunën e Lipjanit është 6,221, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 18,547 ha, numri i njësive blegtorale është 10,360.

Prej kulturave bujqësore që kultivohen në komunën e Lipjanit dominojnë : drithërat dhe perimkulturat.

Në tabelën më poshtë jepet struktura e sipërfaqeve bujqësore në komunën Lipjan.

Tabela 4: struktura e kultivimit të sipërfaqeve bujqësore

Ara sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore/ha	18,547.41 ha
Ara	10,304.87 ha
Kopshte	38.7 ha
Livadhe dhe kullosa	8,091.37 ha
Djerrina	359.88 ha
Toka pyjore	1,790.12 ha
Toka jobujqësore	852.49 ha

2.7 Turizmi lokal

Qyteti i Lipjanit ka potencial të madh turizmit të bazuar kryesisht në vlerat e natyrës, por edhe kulturore siq janë; rezervati blinaja, peisazhet e grykës Shalë-Kleçke dhe vargmalet e Zhegovcit, lokaliteti i Janjevës etj. Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, paraqesin pikat e atraksioneve turistike.

Shpella e Mermertë në Gadime si monument natyrorë paraqet një atraksion të veçantë kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe gjendet në afërsi të Lipjanit pranë rrugës Prishtinë-Ferizaj në fshatin Gadime e Ulët. Shpella e Mermertë quhet ngase është e ndërtuar në shkëmbinj të mermerit dhe është një ndër shpellat më të bukura jo vetëm në Kosovë, por

edhe në Ballkan e me gjere. Ne këtë shpelle paraqiten te gjitha llojet e stolive, stalagmite dhe stalaktite, ne forma dhe madhësi te ndryshme, e posaçërisht prania e Aragoniteve.

Mbajtja e orëve letrare “Shtjefën Gjeqovi” si dhe monumente dhe objekte tjera e bëjnë Janjevën një lokalitet të shkëlqyeshëm turistik.

Turizmi rural është i lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në zonat e larta ka edhe fermer të zhvilluar të cilët mund të ofrojnë shërbime të akomodimit duke dhënë me qira dhoma ose shtëpi të vogla për ata që dëshirojnë të shfrytëzojnë shërbimet cilësore të bujqësisë dhe blegtorisë, natyrës dhe gjahut.

2.8 Arsimi

Drejtoria Komunale e Arsimit e ushtron mbikëqyrjen profesionale pedagogjike mbi institucionet e arsimit-edukimit, Kopshtit të fëmijëve, arsimit parafillor, fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë në komunën e Lipjanit.

Niveli i arsimit në Komunën e Lipjanit, karakterizohet sipas këtyre të dhënave:

- Pa shkollë/fillore e papërfunduar 12.26%
- Fillore e mesme e papërfunduar 29.43 %
- Me shkolle te mesme 49.72%
- Me shkolle te larte 7.22 %
- Pergaditje superiore 1.37%

Tabela 5: Numri i nxënësve sipas niveleve të shkollimit, ASK 2020/21

Numri i nxënësve sipas niveleve të shkollimit				
Parashkollorë	Parafillor	Fillor-mesëm i ulët	Mesëm i lartë	Gjithsej
118	814	8,538	2585	12,055
Numri i mësimdhënësve sipas niveleve				
Parashkollorë	Parafillor dhe Fillor-mesëm i ulët		Mesëm i lartë	Gjithsej
19	678		121	818

Struktura e rrjetit dhe niveleve shkollore - Përbërja e rrjetit dhe niveleve shkollore komunale në Lipjan, ka shtrirje gjithëpërfshirëse në të gjitha vendbanimet. Struktura e niveleve është 0,1,2 dhe 3. Komuna e Lipjanit ka gjithësejt 28 institucione edukativo-arsimore amë me 33 paralele të ndara fizike, 30 në gjuhën shqipe dhe 3 në gjuhën serbe. Gjithësejt shkolla të mesme janë Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan me paralele të ndara në Shalë dhe Gadime, si dhe Shkolla e Mesme Profesionale “ Adem Gllavica në Lipjan.

Në kuadër të 28 institucioneve, kemi edhe shkollën speciale për nivelet e shkollimit 1,2 dhe 3 në Shtëpinë Korrektuese, QEA “Mehmet Akif” në Banullë, Qendra trajnuese në kuadër të SHMP” Adem Gllavica” – Norges Vel, si dhe Kampusin e UBT-së”.

Në komunë funksionojnë dy Qerdhe, një në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën serbe, që të dyja funksionojnë në qytetin e Lipjanit.

2.9 Shëndetësia

Organizimi i Kujdesit Parësor Shëndetësor në Lipjan bëhet në përputhshmëri të plotë me rregullativën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë sipas Konceptit të Mjekësisë Familjare. Bartës kryesor i këtij koncepti është Mjeku Familjar dhe Institucionet e Kujdesit parësor Shëndetësor sic janë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanta e Mjekësisë Familjare (AMF).

Kujdesi Parësor Shëndetësor në Komunën e Lipjanit është e organizuar përmes 12 institucioneve të KPSHsë që përfshijnë: o Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) – institucioni themelor i KPSH, o Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) - si njësi përbërëse të QKMF o Ambulantat e Mjekësisë Familjare (AMF) – si njësi përbërëse të QMF-së. Ndërsa rrjeti i këtyre institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor përbëhet nga: 1 QKMF në qytetin e Lipjanit; 4 QMF– Shalë, Magure, Gadime dhe Janjevë; 7 AMF - Kraishtë, Dobrajë e Madhe, Rubovc, Banullë, Babush i Muhaxherëve, Smallushë dhe Slllovi.

Tabela 6: Stafi i angazhuar në Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor e Komunës së Lipjanit

Stafi	Specialist të MF	Doktor të mjekësisë	Specialist të pediatri	Specialist të gjinekologjisë	Specialist të stomatologjisë	Mami	Teknik të farmacistë	Teknik të stomatologjisë	Infermierë	Teknik të laboratorit
Nr	25	18	2	2	5	5	4	4	98	12

Tabela 7: Vizitat në kujdesin parësor shëndetësor në Lipjan, ASK-statistikat e shëndetësisë 2021

Lloji vizitës	Mjekësia familjare	Intervenime-shërbime	Laboratori	Shërbime stomatologu
Numri	17,6945	12,9730	17,238	8,820

Në Komunën e Lipjanit veprimtarinë e kujdesit shëndetësorë e realizojnë edhe një numër i barnatoreve dhe ordinancave private, të cilat ofrojnë shërbime të pediatri, kardiologjisë, gjinekologjisë, stomatologjisë, laboratorit, mjekësisë familjare, ortopedisë, fizioterapisë, kirurgji ambulante, dermatologji dhe shërbime të ngjajshme specialistike.

2.10 Administrata publike

Sipas statutit të komunës së Lipjanit, organet e komunës janë: Kuvendi i Komunës- organi më i lartë i Komunës dhe Kryetari i Komunës-organi ekzekutiv i Komunës.

Kuvendi i Komunës udhëhiqet nga Kryesuesi i Kuvendit, kuvendi përbëhet nga 31 anëtarë, kurse organi ekzekutiv udhëhiqet nga Kryetari i Komunës, ka dy nënkryetar dhe 12 Drejtor që udhëheqin drejtoratet përkatëse.

Administrata komunale përbëhet nga Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoratet Komunale, Zyra e personelit dhe Njësia për Auditimin e brendshëm. Drejtoratet komunale janë 12.

Në vazhdim jepet organogrami i komunës së Lipjanit. Komuna me aktemërim e ka të caktuar edhe zyrtarin për menaxhimin e mebturinave.




Figura 1. Struktura organizative e Amnistratës Komunale në Lipjan

2.11 Dokumentet relevante kommunale

Planet e dhe dokumentet strategjike të komunës së Lipjanit, të përshkruara në vijim, pos tjerash rregullojnë dhe trajtonë aspektet e MM:

- **Plani zhvillimor i Komunës së Lipjanit 2013-+2023+ -** është document strategjik për një zhvillim të qëndrueshëm të komunës së Lipjanit, përmes shfrytëzimit racional të resurseve, ruajtjen e vlerave natyrore dhe hapsirës, harmonizimin me kërkesat sociale, ekonomike dhe mjedisore.
- **Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal-** si qëllim kryesor e ka përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të komunës së Lipjanit, përmes avansimit të kushteve të zhvillimit të biznesit, lehtësimit të shëbrimeve administrative, përmirsimin e infrastrukturës, dresimin e taksave etj.

- Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës - e cila ka për qëllim që të rregulloj sistemin e ofrimit të shërbimit të mbledhjes së Mbeturinave komunale si dhe aspektet tjera operative dhe financiare.
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

3 Gjendja ekzistuese

3.1 Të dhënat për mbeturina në komunën e Lipjanit

Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave

Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të raporteve nga komuna dhe operatori për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale KRM "Pastrimi" Sh. A. (tutje operatori) është siguruar një bazë solide e të dhënave për të nxjerrë një rezultat të besueshëm të nivelit të gjenerimit të mbeturinave komunale gjatë vitit 2021. Duhet të cekim se këto dhëna nuk mjaftojnë për të siguruar një pasqyrë të kompozicionit të mbeturinave në nivel të komunës.

Megjithatë, bazuar në të dhënat e siguruar nga raportet e komunës dhe operatori, prej sasisë totale të mbeturinave të grumbulluara mund të llogaritet një gjenerim mesatar i mbeturinave për banorë në nivel të komunës së Lipjanit. Kështu nga 13,053 ton mbeturina komunale të grumbulluara në komunën e Lipjanit për vitin 2021, si dhe numrin e banorëve të shërbyer që është vlerësuar në 53,614 banorë, rezulton se gjenerimi i mbeturinave komunale për kokë banori në komunën e Lipjanit për vitin 2021 të jetë në 243.5 kg/banor/vit.

Tabela 8: Bilanci i mbeturinave komunale në Komunën e Lipjanit

Bilanci i mbeturinave komunale							
Kategoria	Mënyra e përcaktimit të sasisë	Mbeturinat e grumbulluara			Mbeturinat e dorëzuara		
		Nga operatorët e grumbullimit	Nga ricikluesit	Nga deponitë ilegale	Mbeturinat e ricikluara	Mbeturinat e tregtuara	Mbeturinat e deponuara
Mbeturina mikse komunale	Peshim	13,053 t					13,053 t
Total:		13,053 t					13,053 t

3.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në tërë teritorin e Komunës së Lipjanit ofrohet nga operatori KRM "Pastrimi" Sh.A., njësia në Lipjan. Ky operator grumbullon mbeturinat nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet në komunë dhe i transporton në deponinë sanitare rajonale në Mirash.

Tabela 9: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale

Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale				
Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e menaxhuar e mbeturinave	Mbulimi me shërbim ¹ %	Statusi i kontraktimit (po/jo)

¹ Mbulimi me shërbim është dhënë vetëm për EF

KRM "Pastrimi" Sh.A	Publike	Mbeturina komunale	93.1%	Po
---------------------	---------	--------------------	-------	----

Mbulimi me shërbim

Shërbimi themelor që komuna dhe operatori aktualisht e ofrojnë për qytetarët është mbledhja, transporti dhe deponimi përfundimtar në deponi sanitare i mbeturinave komunale.

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare deri në fund të vitit 2021 në komunën e Lipjanit ka arritur në 93.1%. Ndërkaq sa i përket mbulimit me shërbim për bizneset ajo ka arritur në 61.6%, respektivisht 79.2% për institucione.

Tabela 10: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës

Mbulimi me shërbim në territorin e komunës						
Emri i operatorit	Numri i EF ²	Numri i EF të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
KRM Pastrimi SH.A.	9,497	8,839	3,076	1,895	96	76

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale në të gjitha lokalitetet e komunës së Lipjanit është dhënë në tabelën në vijim (tab. 11). Deri më tani në komunën e Lipjanit nuk është vendosur ndonjë infrastrukturë e ndarjes së mbeturinave në burim. Andaj, e gjithë sasia e mbeturinave që gjenerohet hudhet direkt (në mënyrë të pandarë) në kontejnerë të përbashkët në zonën urbane dhe në kontejner familjarë në zonat rurale dhe dërgohet në deponinë e Mirashit.

Tabela 11: Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit

Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit				
Nr.	Vendbanimi	Numri i EF	Numri EF të shërbyera	Mbulimi me shërbim %
1	Akllap	108	28	26%
2	Babush i Muhaxherve	214	102	48%
3	Baic	141	98	70%
4	Banullë	286	158	55%
5	Bregi i Zi	74	37	50%
6	Bujan	105	44	42%
7	Brus	46		0%
8	Bukovicë	1		0%
9	Divlakë	10		0%
10	Dobraj e Madhe	358	136	38%
11	Dobraj e Vogël	33	4	12%
12	Gadime e Epërme	438	196	45%
13	Gadime e Ulët	539	256	47%
14	Zllakuqan	39	11	28%
15	Gllanic	9	2	22%

² Regjistrimi i popullsisë, ASK-2011

Komuna e Lipjanit

16	Gllavicë	41	17	41%
17	Glllogoc	240	88	37%
18	Grackë e Vjetër	45	37	82%
19	Grack e Vogël	68	47	69%
20	Gumnasellë	183	78	43%
21	Hallaq I Madh	62	18	29%
22	Hallaq I Vogël	108	62	57%
23	Hanaroc	8		0%
24	Janjevë	401	102	25%
25	Kleçkë	23		0%
26	Kojskë	62	23	37%
27	Konjuh	114	90	79%
28	Kroishtë	214	65	30%
29	Krojmir	217	75	35%
30	Leletiq	58	20	34%
31	Lipjan	1378	1893	137%
32	Lagjja e Hashanve	?	11	
33	Lagjja e Re 1	?	41	
34	Lagjja e Re 2	?	16	
35	Llugë	48	17	35%
36	Llugaxhi	196	112	57%
37	Magure	289	125	43%
38	Marevc	47	21	45%
39	Medvec	198	35	18%
40	Mirenë	75	45	60%
41	Okosnicë	1		0%
42	Plitkoviq	7		0%
43	Poturoc	117	38	32%
44	Qollopek	49	20	41%
45	Qylagë	148	46	31%
46	Resinoc	109	49	45%
47	Ribar I Madh	347	138	40%
48	Ribar I Vogël	104	23	22%
49	Rubofc	131	46	35%
50	Rufc I Ri	86	57	66%
51	Rufc I Vjetër	159	39	25%
52	Shalë	367	163	44%
53	Shisharkë	0		
54	Silovi	561	171	30%
55	Smallushë	190	72	38%
56	Teqe	30		0%
57	Terbuc	4		0%
58	Topliqan-Jeta e Re	239	163	68%
59	Torinë	111	44	40%
60	Vershec	135	78	58%
61	Vogaqicë	0		
62	Vrellë	19		0%
63	Vrell e Goleshit	37	22	59%
64	Varigoc	31	8	26%
Gjithsej		9419	5287	56%

Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Ofrimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave në komunën e Lipjanit është i organizuar në tri zona: zonën urbane, zonën periurbane dhe në zonën rurale. Në tabelën në vijim shtë dhënë tipologjia dhe frekuenca aktuale e ofrimit të shërbimit të mbledhjes së mbeturinave në komunën e Lipjanit.

Tabela 12: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit

Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit				
Vendbanimi	EF të shërbyera derë më derë %	Frekuenca e shërbimit	EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët %	Frekuenca e shërbimit
Zona urbane qendra ³	80%	7/7	20	1/7
Zona periurbane ⁴	100%	1/7	-	-
Zona rurale	100%	1/7	-	-

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Në tabelën në vijim janë listuar të gjitha asetet që janë në përdorim në Komunën e Lipjanit, në funksion të hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale.

Tabela 13: Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave

Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave				
Lloji i kontejnerit	Numri	Gjendje të mire %	Gjendje funksionale %	Gjendje jo të mire %
Shporta 120 l	6550	50%	25	25%
Shporta 240 l	6	100%	-	-
Kontejnerë 1.1 m3 metalik	430	45%	20%	30%
Kontejnerë 7.1 m3	23	100%	-	-

Ndërkaq, në tabelën në vijim është dhënë numri i dhe lloji i pajisjeve për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale.

Tabela 14: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave

Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave					
Brendi	Tipi	Kapaciteti ton apo m3	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja (e mirë /funksionale/e keqe)
Isuzi	kompaktor	1.1	2018	01-352-PG	Mirë
Isuzi	kompaktor	1.1	2018	01-319-LT	Mirë
Mercedes	kompaktor	1.1	-	01-317-OF	Funksionale
Mercedes	kompaktor	1.1	-	01-683-QI	Funksionale

³ Ndërtesa shumëkatëshe me banim kolektiv

⁴ Banim rezidenciale me shtëpi individuale

Komuna e Lipjanit

Ford	kompaktor	1.1	-		Keqe
Mitsubishi	kompaktor	1.1	-		Funksionale
Mercedes	kompaktor	7	-		Funksionale
Reno	kompaktor	1.1	-		
Fiat	Ngarkues (bager)			01-722-JM	Keqe
Skip cat	Ngarkues (bager)				
Ferguson	Traktor	IMT-539	-	?	Funksionale
Mercedes	Kompaktor	14	-	01-367-OA	Keqe

3.3 Rishikimi i implementimit të planit

Komuna e Lipjanit në planin aktual të menaxhimit të mbeturinave 2017-2022, ka pasur 6 objektiva kryesorë si: hartimi i kuadrit ligjor për MM, konsolidimi i shrbimit, nxitja e iniciativave për minimizimin e gjenerimit të mbeturinave, rritja e nivelit të arkëtimit, mbledhja e ndarë e mbeturinave në fraksione të caktuara, si dhe eliminimi i deponive ilegale.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar më detajisht objektivat e planit, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre, si dhe janë dhënë komentet konkrete për secilin objektiv.

Ky rishikim i PKMM aktual, duhet të na shërbej si një mësim dhe si orientim për hartimin e PKMM në vijim, me qëllim që të adresohen qartë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në mospërbushjen e objektivave.

Tabela 15: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual

Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual						
Objektiva e MM	Treguesi i performancës	Caku	Realizimi	Favorshëm / pafavorshëm	Koment	
1 Grumbullimi i mbeturinave	%	90%	93%	Favorshëm		
2 Ndarrja e mbeturinave në burim	%	50%	0%	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës	
3 Trajtimi i mbeturinave	%	40%	0%	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës	
4 Deponimi i mbeturinave	%	60%	100%	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës	
5 Sasia e biodegradueshme e hedhura në mbeturinat komunale	%	40%	100%	Pafavorshëm		
6 Hartimi i databazës		1	0	Pafavorshëm		

Përpos mbulimit me shërbim treguesit tjerët të objektivave të planit nuk janë realizuar si psh ndarrja në burim, riciklimi dhe devijimi i mbeturinave nga deponija. Arsyet e kësaj mospërbushjeje kanë të bëjnë me mungesën e infrastrukturës si dhe zbatimin e dobët të projekteve. Poashtu edhe caqet e planit mundën të konsiderohen si jorealiste optimiste meqë nuk janë bazuar në kapacitetet reale dhe nuk i kanë adresuar rreziqet e mospërbushjes.

3.4 Performance e shërbimit

Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Cilësia e shërbimit dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimit mund të cungohen rëndë nëse shërbimet nuk ofrohen në një mënyrë ekonomike dhe me kosto efektive. Ofrimi i shërbimeve joefikase është pengesë kryesore zhvillimore e cila duhet të adresohet.

Kostot e grumbullimit të mbeturinave ndryshojnë ndjeshëm në varësi të nivelit dhe tipologjisë së ofrimit të shërbimeve. Prandaj, efikasiteti i koston matet dhe vlerësohet në lidhje me vlerësimin e koston kur përcaktohet niveli i tarifës së shërbimit.

Stafi i angazhuar në MM përfshin stafin direkt të përfshirë në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të MM. Stafi paraqet rreth 50% të shpenzimeve operative prandaj si i tillë është shumë me interes të përcillet dhe të tentohet përmirësimi i efikasitetit të tij.

Tabela 16: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM

Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM	
Kategoria	Numri i stafit
Stafi direkt	
Kryepunëtorë	2
Shoferë	11
Punëtorë	36
Total staf direkt:	49
Staf indirekt dhe administrativ	
Drejtorët e bordit	1
Menaxhmenti i lartë ⁵	1
Zyrtarë të rangut të mesëm	4
Staf teknik	1
Zyrtarë të rangut fillestar	4
Staf tjetër	5
Total staf indirekt dhe administrative:	16
Total staf të MM	65
Mbeturina të grumbulluara (2021)	13,053 t
Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara	4.9
EF të shërbyera	8,839
Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera	7.4

⁵ KE, ZKF, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

Performanca e aseteve të grumbullimit dhe transportit:

Asetet komunale për menaxhim të mbeturinave, që tregojn një efikasitet të kënaqshëm në realizimin e shërbimit për çka janë të dedikuar, janë mjeti elementar për aritjen e përmbushjes së objektivave të një komune lidhur me menaxhimin e mbeurinave.

Asete komunale janë të gjitha pajisjet të cilat janë në pronë të komunës apo janë pronë e kompanisë publike (në të cilën komuna ka pronësi). Sa më e lartë performanca e aseteve aq më e vogël do të jetë kostoja e ofrimit të shërbimit të hudhjes, mbledhjes dhe transportit të mbeturinave. Duhet bëhet analizë e rregullt e shfrytëzimit sa më racional të aseteve, shpenzimet e naftës, amortizimin e makinerisë etj., që nëse na dalin si tregues të pafavorshëm, atëherë kjo imponon nevojën që të analizohen dështimet operationale si zonimi, mungesa e stacionit transfer të mbeturinave etj.

Tabela 17: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	
Kategoria	Performanca
Kamionët në operim	9
Kapaciteti maksimal operues (ton)	29 ton
Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit)	13,053.12 ton
Xhiro (xhiro/vit)	NA
Kilometrazhi (km/vit)	NA
Konsumi i naftës (l/vit)	10,036.45 l
Efikasiteti i Shfrytëzimit %	
Efikasiteti i shfrytëzimit të kamionëve	100%
Konsumi i naftës l/100km	NA
Konsumi i naftës l/ton	NA

3.5 Performanca financiare e MM

3.5.1 Shpenzimet e shërbimit të MM

Shpenzimet janë ndarë në shpenzime të pagave, shpenzime të materialit direkt dhe shpenzimet indirekte dhe administrative.

Shpenzimet e materialit direkt përfshijnë zërat si nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

Shpenzimet indirekte dhe administrative përfshijnë zërat si: tatimi mbi fitimin; tatimi mbi pronë; sigurimi; pagesa e licencave; shërbime komunale; kostot e komunikimit; kostot e trajnimit; shpenzimet e përfaqësimit; qeraja; kostot e transportit; të konsumueshme dhe shpenzime të tjera administrative.

Tabela 18. Shpenzimet e shërbimit të MM

Shpenzimet e shërbimit të MM		
Kategoria e kostove dhe shpenzimeve	Kostot (€/vjet)	Pjesëmarrja %
Shpenzimet e pagave	260,022.00	47%
Shpenzimet e materialit direkt ⁶	174,602.97	31%
Shpenzimet indirekte dhe administrative	122,844.44	22%
Amortizimi	/	/
Total:	557,469.41	100%

3.5.2 Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të hyrat nga arkëtimi i ofrimit të shërbimit të MM iu referohen të hyrave operative primare dhe sekondare.

Tabela 19: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM		
	Të hyrat	Arkëtimi
Të hyrat operative		
-Amvisëritë	459,081.90	417,927.25
-Bizneset	47,815.40	42,050.72
-Institucionet	1,689.84	218.76
-Nga shërbimet tjera të kontraktuara	/	/
Total:	508,587.14	460,196.73

3.5.3 Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Në tabelën në vijim është pasqyruar hapi final që është krahasimi i kostove dhe të hyrave si dhe kalkulimi i treguesve përfundimtar të performancës si në tabelën në vijim. Nga tabela mundet të konkludohet se të hyrat e shërbimeve nuk i mbulojnë kostot e shërbimit dhe se nevojiten të rishikohen tarifat si dhe të shkurtohen kostot përmes përmirësimit të efikasitetit operativ

Tabela 20: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit	
Kostot e MM	557,469.41
Të hyrat e MM	508,587.14
Arkëtimi	460,196.73
Shkalla e mbulimit faturim %	85.3 %
Shkalla e mbulimit arkëtim %	90.49%
Kosto për ton të mbeturinave	42.7 €/ton

⁶ Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

3.6 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

Qendrat e transferit dhe të riciklimit

Komuna e Lipjanit nuk ka infrastrukturë të ndërtuar të stacionit të transferit të mbeturinave. Kështu që sasia e mbeturinave të grumbulluara nga operatori dërgohen për deponim në deponin sanitare rajonale në Mirash. Në komunën e Lipjanit operojnë disa grumbullue joformal të mbeturinave, kryesisht: metalit, plastiks-najllonit, letrës-kartonit, me qëllim të shitjes së këtyre materialeve tek operatorët e brendshëm që merren me riciklimin e tyre, apo edhe i eksportojnë jashtë vendit.

Deponia

Komuna e Lipjanit nuk menaxhon me deponi të mbeturinave. E gjithë sasia e mbeturinave komunale që grumbullohen nga operatori në teritorin e komunës drejtëpërdrejtë dërgohen për deponim në deponinë sanitare rajonale në Mirash.

3.3 Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

- Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme

Nuk ka ndonjë organizim të mirëfillt të menaxhimit të kësaj kategorie të mbeturinave. Për pasojë këto mbeturina përfundojnë të hudhura dhe të patrajuara deri më tani.

- Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi

Komuna e Lipjanit e ka caktuar lokacionin për deponimin e mbeturinave të konstruktiv-demolimit të objekteve. Mirëpo, për shkak se deri më tani ende nuk është funksionalizuar ky lokacion, kjo kategori e mbeturinave vazhdon të mbetet e patrajuar dhe vërejmë se kemi hudhje të këtyre mbeturinave në vende të ndryshme pa asnjë kriter. Zakonisht hudhja e këtyre mbeturinave bëhet shkaktar që në atë lokacion gradualisht të hudhen edhe mbeturina tjera duke krijuar kështu një deponi ilegale. Andaj, në të ardhmen kjo situatë duhet të trajtohet me prioritet dhe t'i bëhet një zgjidhje adekuate kësaj kategorie të mbeturinave.

- Menaxhimi i mbeturinave shtazore

Menaxhimi i mbeturinave shtazore është një sfidë në vete për komunën. Megjithatë sipas legjislacionit në fuqi kjo kategori e mbeturinave nuk është përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e komunave, aktiviteti ndodhë në teritorin e komunës dhe nga keqmenaxhimi i këtyre mbeturinave atakohet mjedisi dhe shëndeti i qytetarëve. Forma aktuale e trajtimit të mbeturinave shtazore nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit (AVUK), është përmes kontraktimit të një operatori i cili e bën groposjen dhe dezinfektimin e zones ku groposën kafshët e ngordhura, kur paraqiten sëmundje të kashëve shtëpiake. Mirëpo, problemi qëndron me mbeturinat nga burime tjera siq janë: therrtoret, mbetjet e

shtazore që hudhen nga familjet, ngordhjet e qenve endacak etj., të cilat në munges të një sistemi për menxhimin e tyre fatkeqësisht përfudnojnë gjithandej.

- *Menaxhimi i mbeturinave medicinale*

Mbeturinat e kudesit shëndetësorë që gjenerohen në komunën e Lipjanit nga institucionet publike (QKMF dhe AMF), grumbullohen nga operatori i kontraktuar. Një pjesë e këtyre mbeturinave dërgohen për trajtim të mëtutjeshm në sterilizatorin e vendosur në QKUK, kurse pjesa tjetër i nënshtohet procesit të asgjësimit. Ndërkaq, për mbeturinat që gjenerohen nga operatorët privat të kujdesit shëndetësor nuk ka ndonjë të dhënë të saktë se si qëndron menaxhimi i tyre. Sipas legjislacionit në fuqi këto institucione janë të obliguara që të kenë kontratë me operatorë të licencuar për menaxhimin e mbeturinave të kujdesisht shëndetësorë.

- *Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave*

Për kategoritë tjera të mbeturinave që gjenerohen në komunën e Lipjanit, siq janë: bateritë, vajrat mbeturinë, mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, nuk ka ndonjë të dhënë se si qëndron gjendja e tyre. Andaj, është e domodoshme që në të ardhmen të hulumtohet gjendja dhe të adresohet zgjidhja e menaxhimit të këtyre mbeturinave të dëmshme për mjedisin.

4 Objektivat e MM dhe plani operacional

4.1 Vizioni i MM

Komuna e Lipjanit është një komunë e cila promovon menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave të bazuar në parimet e ekonomisë qarkore me synim mbrojtjen e mjedisit, prezervimin e resurseve natyrore dhe zhvillimit ekonomik lokal!

Komuna e Lipjanit synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar me qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim, dhe riciklim komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

4.2 Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e në vijim:

Tabela 16: Lista e propozuar e objektivave të planit	
Numri objektivit	Emërtimi
Objektivi 1	Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
Objektivi 2	Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Objektivi 3	Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
Objektivi 4	Eliminimi i deponive ilegale
Objektivi 5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

4.3 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Lipjanit është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

Tabela 25: Korniza strategjike e Objektivit 1								
Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
1.1	Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /pcp /ditë)	Sasia e mbeturinave të grumbulluara nga	0.71	0.66	0.60	0.55	0.5	0.5

		ofruesi i shërbimeve (kg /pkb/ditë)						
1.2	Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara	Shërbimi është riorganizuar që të mundësoj matjen në pikën e grumbullimit			1			
1.3	Zbatimi i tarifave volumetrike	Tarifat volumetrike janë miratuar dhe po aplikohen				1		
1.4	Futja e pakos stimuluese	Pako stimuluese është hartuar dhe miratuar				1		
1.5	Shpërndarja e komposterëve individual	Numri i komposterëve individual të shpërndarë për EF dhe biznese „zero ëaste“		50	50	50	50	100
1.6	Zbatimi i fushatës informative për parandalimi dhe minimizim të gjenerimit të mbeturinave	Fushata informative po zbatohet		1	1	1	1	1

4.3.1 Masat dhe aktivitetet për zbatimin e Objektivit 1

Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar zbatimin e tarifave me bazë matjen:

Mënyra e organizimit të tanishëm të shërbimit përveq bizneseve të mëdha dhe institucioneve nuk bazohet në matjen e mbeturinave të gjeneruara për grumbullim. Edhe tek rasti i grumbullimit derë më derë për amvisërit në zonat rezidenciale dhe rurale prap nuk bëhet matja për amvisëri të shërbyer. Kjo mënyrë e shërbimit e pamundëson zbatimin e tarifave në bazë të matjes dhe si e tillë duhet të transformohet. Poashtu ofruesit e shërbimeve nuk e kanë teknikën e as kapacitetin për ta zbatuar volumetrinë.

Për të riorganizuar shërbimin komuna do të bëjë:

- Planin e riorganizimit të shërbimit i cili do të mundësoj zbatimin e matjes së mbeturinave në pikën e grumbullimit
- Sigurimi i infrastrukturës për matjen e gjenerimit të mbeturinave të grumbulluara
- Trajnimi i stafit të ofruesit të shërbimeve për të zbatuar skemën PAYT.

Zbatimi i tarifave volumetrike bazuar në matje

Tarifat aktuale janë të përcaktuara në bazë të sasisë së paramenduar të gjenerimit të mbeturinave për amvisëritë dhe bizneset. Problemi me këto tarifa është se nuk e promovojnë reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes pagesës ndërsa disa konsumatorë me gjenerim më të madh

përfitojnë nga pagesa më e ulët se kostoja e shërbimit. Për të kaluar në tarifat volumetrike do të zbatohen aktivitetet sa vijon:

- Kalimi i tarifave të shërbimit në bazë të matjes
- Azhurnimi i softuerit të faturimit që të mundësoj tarifat e bazuara në matje
- Zbatimi i tarifave PAYT

Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset me „zero ambalazhim“ dhe “zero mbeturina”:

Komuna ka interes që të zhvilloj ekonomi lokale të bazuar në ekonomi qarkore dhe bazë të qendrueshme. Ideja është që këto biznese të veprojnë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në vendet e BEs dhe më gjerë po hapen dyqane të cilat shesin produktet e tyre pa ambalazhim si dhe restorantet të cilat i kompostojnë mbeturinat e tyre nga ushqimet.

Ideja është që këto dyqane të jenë më konkurente me çmime më të lira të cilat do i bënin atraktive për konsumatorët. Poashtu konsumatorët me vetëdije më të lartë mjedisore do tu ofrohej mundësia që të i kryenin furnizimet në këto dyqane.

Komunat do të luaj rolin e sajë që të i promovoj këto biznese dhe përmes lehtësimeve fiskale të e lehtësojnë afarizmin e tyre. Disa nga masat të cilat do ti ndërmerr komuna janë:

- Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal dhe kostove dhe përfitimeve
- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal përfshi tarifat preferenciale;
- Analizë e zbatimit të prokurimit të gjelbër për këto subjekte;

Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante “zero mbeturina”:

Komuna do të shpërndaj falas nga 50 komposterë individual çdo vit që nga 2023 për të reduktuar mbeturinat e hudhura në kontejnerët apo shportat që grumbullohen dhe transportohen nga operatori.

Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave përmes fushatave informuese.

Komuna në mënyrë kontinuale do të organizoj fushatë informuese për qytetarët bizneset dhe institucionet mbi rëndësinë e parandalimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave si dhe këshillat për ta arritur këtë objektivë.

4.4 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objekti ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 3 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

Tabela 26: Korniza strategjike e Objektivit 2

Nr.	Masat / aktivitet / treguesi i performancës	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
2.1	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit është zbatuar			1			
2.2	Studim i fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklmit dhe modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklmit të mbeturinave komunale	Studimi i fizibilitetit është zbatuar		1				
2.3	Zgjerimi i mbulimit me shërbim të ndarjes së mbeturinave në burim	% EF me shërbim të ndarjes në burim		10%	20%	30%	40%	50%
2.4	Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese	% e riciklmit të plastikës, letres, kartonit, qelqit dhe metalit.	0%	5%	10%	15%	20%	25%
